

VENDIM  
Nr.418, date 9.7.1998

PER PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TE NDERMARRJEVE TE FALIMENTUARA NE  
RRUGE ADMINISTRATIVE

Ne zbatim te dekretit te Presidentit te Republikës nr.1561, date 25.7.1996 "Për një shtese ne ligjin nr. 8017, date 25.7.1995 "Për procedurat e falimentimit"" miratuar me ligjin nr.8140, date 5.9.1996, me propozimin e Ministrisë se Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e falimentimit dhe te likuidimit ne rruge administrative te këtyre ndërmarrjeve: Uzina 12 ne Kombinatin Metalurgjik Elbasan, Uzina e sode-PVC-se ne Vlore, Fabrika e letrës Kavajë.

2. Likuidimi i ndërmarrjeve te shpallura te falimentuara kryhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Caktimi i likuidatorit ose likuidatorëve, miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Shitja e ndërmarrjeve ne likuidim behet sipas procedurave te vendimit te Këshillit te Ministrave nr.192, date 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit te pronës shtetërore, qe privatizohet dhe procedurat e shitjes", me miratimin e Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Mjetet e xhiros mund te shiten ne treg te lire, me çmimet korente.

5. Me miratimin e Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, mbi bazën e raportit te eksperteve vlerësues, mund te nxirren jashtë përdorimit linja e reparte te ndërmarrjeve te shpallura te falimentuara ne rruge administrative.

6. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit miraton dhe nxjerr udhëzime te posaçme për fillimin dhe zbatimin e procedurave te demolimit, për linjat e repartet e nxjerra jashtë përdorimit, sipas pikës 5 te këtij vendimi.

Shpenzimet e demolimit përballohen me fondet qe sigurohen nga shitja e mbetjeve te dala prej tij.

7. Për objektet e ndërmarrjeve te falimentuara, qe janë ne procesin e likuidimit dhe qe deri ne datën e daljes se këtij vendimi janë zënë nga familjare, te zbatohen procedurat e vendimit te Këshillit te Ministrave nr.197, date 20.3.1998 "Për nxjerrjen jashtë përdorimit te objekteve qe nuk kane qene e mundur te shiten" .

**8. Arkëtimet ne leke te vlerave te shitjes se pasurisë dhe te detyrimeve debitore te ndërmarrjes ne likuidim derdhen ne llogarinë e hapur prej saj, pranë Bankës Kombëtare Tregtare.**

Bankave, organeve te tatimeve, si dhe organeve te tjera shtetërore u ndalohet te vene dore ne llogarinë e veçante te ndërmarrjes ne likuidim.

**Mjetet monetare te kësaj llogarie disponohen vetëm me urdhër te Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.**

**Përdorimi i te ardhurave ne leke behet me miratimin e Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas kësaj radhe:**

**a) për te përballuar pagat dhe shtesat mbi page për punonjësit e ndërmarrjes ne likuidim;**

b) për shlyerjen e detyrimeve, deri ne kufirin qe lejojnë shumat e arkëtuara ne leke.

Shlyerja e detyrimeve ndaj kreditoreve mund te behet edhe pjese-pjese, pa pritur likuidimin e plote te ndërmarrjes. Radha e shlyerjes se kreditoreve miratohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

**c) për te përballuar te gjitha shpenzimet e tjera, qe lidhen me administrimin, ruajtjen dhe likuidimin e ndërmarrjes.**

9. Teprica qe mund te rezultojë, pasi te zbriten nga totali i te ardhurave ne leke përdorimet sipas pikës 8 te këtij vendimi, me miratimin e Ministrisë se Financave, derdhet ne Buxhetin e Shtetit.

10. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse për te.

11. Vendimi i Këshillit te Ministrave nr.620, date 16.9.1996 "Për shpalljen e falimentimit dhe kalimin ne likuidim te disa ndërmarrjeve ne varësi te Agjencisë se Ristrukturimit te Ndërmarrjeve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

Fatos Nano

**Per procedurat e likuidimit te ndermarrjeve te falimentuara ne rruge administrative.**

#### **Aktet që kanë ndryshuar aktin e mësipërm:**

[Për një shtesë në vendimin nr. 418, datë 09.07.1998 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative"](#) 

**Vendim i KM, Nr.272, Dt.Aktit:20.06.2002, Dt.Miratimit:20.06.2002, Flet.Zyrtare Nr.30, Faqe:945** [Përmbajtja \( HTML - DOC \)](#)

Akti pëson ndryshimin: **Ndryshim neni/pike** në nenin 1 nga neni 1 i aktit ndryshues.


Shënime: Kudo ne vendimin nr. 418, date 9.7.1998 te Keshillit te Ministrave, emertimi "Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit", zevendesohet me "Ministria Pergjegjese per Industrine".

[Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 09.07.1998 "Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative"](#) 

**Vendim i KM, Nr.409, Dt.Aktit:31.08.1999, Dt.Miratimit:31.08.1999, Flet.Zyrtare Nr.0, Faqe:37** [Përmbajtja \( HTML - DOC \)](#)

Akti pëson ndryshimin: **Shtim neni/pike** në nenin **1** nga neni **1** i aktit ndryshues.

Shënime: Ne vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 418, date 9.7.1998 "Per procedurat e likuidimit te ndermarrjeve te talimentuara ne rruge administrative" , ne piken 1, paragrafi i dyte, bëhet shtese.

[Per nje ndryshim ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 418, date 9.7.1998 "Per procedura te likuidimit te ndermarrjeve te falimentuara ne rruge administrative"](#) 

**Vendim i KM, Nr.113, Dt.Aktit:18.03.1999, Dt.Miratimit:18.03.1999, Flet.Zyrtare Nr.0, Faqe:146** [Përmbajtja \( HTML - DOC \)](#)

Akti pëson ndryshimin: **Ndryshim neni/pike** në nenin **1** nga neni **1** i aktit ndryshues.

Shënime: Ne vendimin e Keshillit të Ministrave nr.418, date 9.7.1998, ne piken 1, paragrafi i dyte, fjalet "Uzina 12 ne Kombinatin Metalurgjik ne Elbasan" zevendesohen me fjalet "Uzina 12 dhe Nikel-Kobaltit ne Elbasan":